18			Vig Mnele	351
19			Shllak	352
1	Puke			353
2		Puke		354
3		Fushe Arrez		355
4			Blerim	356
5			Iballe	357
6			Fierze	358
7			Gjegjan	359
8			Qafe Mali	360
9			Qelez	361
10			Qerret	362
11			Rrape	363
1	M .Madhe			364
2		Koplik		365
3			Gruemire	366
4			Kastrat	367
5			Kelmend	368
6			Qender	369
7			Shkrel	370

QARKU TIRANE

Nr.	RRETHI	BASHKIA	KOMUNA	KODI G.J.C.
1	Tirane			371
2		Bashkia Tirane		372
		Njësia Bashkiake Nr. 1		373
		Njësia Bashkiake Nr. 2		374
		Njësia Bashkiake Nr. 3		375
		Njësia Bashkiake Nr. 4		376
		Njësia Bashkiake Nr. 5		377
		Njësia Bashkiake Nr. 6		378
		Njësia Bashkiake Nr. 7		379
		Njësia Bashkiake Nr. 8		380
		Njësia Bashkiake Nr. 9		381
		Njësia Bashkiake Nr. 10		382
		Njësia Bashkiake Nr. 11		383
3		Kamez		384
		Bathore		385
4		Vore		386
5			Baldushk	387
6			Berzhite	388
7			Berxull	389
8			Dajt	390
9			Farke	391
10			Kashar	392
11			Ndroq	393
12			Paskuqan	394
13			Petrole	395
14			Peze	396
15			Preze	397
16			Shengjergj	398
17			Vaqarr	399
18			Zall Bastar	400
19			Zall Herr	401
20			Krrabe	402
1	Kavaje			403
2		Kavaje		404
3		Rrogozhine		405
4			Golem	406
5			Gose	407
6			Helmes	408
7			Kryevidh	409
8			Lekaj	410
9			Luz i vogel	411
10			Sinaballaj	412
11			Synej	413

QARKU VLORE

Nr.	RRETHI	BASHKIA	KOMUNA	KODI G.J.C.
1	Vlore			414
2		Vlore		
		Rajoni 1		415
		Rajoni 2		416
		Rajoni 3		417
		Rajoni 4		418
		Rajoni 5		419
3		Himare		420
4		Orikum		421
5		Selenice		422
6			Armen	423
7			Brataj	424
8			Hore Vranisht	425
9			Kote	426
10			Novosele	427
11			Qender	428
12			Sevaster	429
13			Shushice	430
14			Vllahine	431
1	Sarande			432
2		Sarande		433
3		Konispol		434
4			Aliko	435
5			Dhiver	436
			(Dhiver2)	437
6			Ksamil	438
7			Livadhja	439
8			Lukove	440
9			Markat	441
10			Xarre	442
1	Delvine			443
2		Delvine		444
3			Finiq	445
4			Mesopotam	446
5			Vergo	447

VENDIM

Nr. 829, datë 11.12.2003

PËR MBROJTJEN E VEÇANTË TË PUNONJËSIT TË GARDËS SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË, KUR, PËR SHKAK TË DETYRËS, I KËRCËNOHET JETA, FAMILJA OSE PRONA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20 dhe 42 të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e Gardës së Republikës të Shqipërisë që, për shkak të veprimtarisë së shërbimit, i kërcënohet jeta, familja ose prona, i sigurohet mbrojtje e veçantë.

2. Me mbrojtje të veçantë, në kuptim të këtij vendimi, kuptojmë masat me karakter organizativ e profesional, që merren për mbrojtjen e punonjësit të kërcënuar.

3. Për vlerësimin e kërcënimeve dhe për mënyrën e sigurimit të mbrojtjes së punonjësit të kërcënuar të Gardës së Republikës të Shqipërisë, të krijohet komisioni i posaçëm për vlerësimin e kërcënimeve, i kryesuar nga drejtuesi i komandës qendrore e në përbërje të ketë:

- Drejtorin e RPLSH-së.....anëtar;
- Shefin e sektorit të analizës.....anëtar;
- Shefin e personelit.....anëtar;
- Eprorin direkt të punonjësit të kërcënuar.....anëtar;

4. Komisioni i vlerësimit merr në shqyrtim rastet e paraqitura për mbrojtje të veçantë, me nismën apo kërkesën e punonjësit të interesuar. Komisioni brenda 3 (tri) ditëve nga paraqitja e rastit të kërcënimit, vendos për marrjen e masave organizative për ruajtjen ose për refuzimin e kërkesës.

5. Komisioni, pas marrjes në shqyrtim të çështjes, merr vendim, i cili përmban:

- pjesën hyrëse, ku përcaktohet baza ligjore, subjekti i kërkesës dhe koha e vendimmarrjes;
- pjesën përshkruese, ku parashtrohen rrethanat që detyrojnë marrjen e masave për ruajtjen e punonjësit të kërcënuar, për ruajtjen e personalitetit të tij, rrezikshmërinë shoqërore të kërcënimeve dhe vlerësimet e të dhënave, të mbledhura për kërcënimin;

- pjesën vendimmarrëse, ku përcaktohet marrja ose jo në mbrojtje të veçantë e subjektit, mënyra e mbrojtjes, koha kur do të merret në mbrojtje dhe afati, shpenzimet, si dhe subjektin që do ta zbatojë vendimin dhe subjektin që do ta kontrollojë zbatimin e tij.

6. Komisioni, me pranimin e kërkesës për mbrojtje të veçantë, përcakton edhe masat konkrete për mënyrën e mbrojtjes, të cilat janë:

- ruajtja fizike;
- ruajtja e banesës ose e pronës;
- transferimi i punonjësit;
- dërgimi jashtë shtetit i punonjësit;
- masa të tjera, në varësi të çështjes.

7. Në rastet kur marrja e masave të mbrojtjes së veçantë të punonjësit të kërcënuar duhet të jetë e menjëhershme, kjo bëhet me urdhër të komandantit të Gardës së Republikës të Shqipërisë, deri në marrjen në shqyrtim nga komisioni i vlerësimit të kërcënimit.

8. Vendimi i komisionit të vlerësimit të kërcënimit miratohet nga komandanti i Gardës së Republikës të Shqipërisë dhe, brenda 3 ditëve, vihet në dijeni dhe Ministri i Rendit Publik.

9. Ndaj vendimit të komisionit të vlerësimit të kërcënimit, i interesuari mund të bëjë ankim te Ministri i Rendit Publik, vendimi i të cilit është përfundimtar.

10. Shpenzimet për mbrojtjen e veçantë të punonjësit të kërcënuar të përballohen nga buxheti i shtetit, i miratuar për Gardën e Republikës së Shqipërisë.

11. Ngarkohet Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

12. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.833, datë 11.12.2003

PËR FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 8 të ligjit nr.9009, datë 13.2.2003 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti i Auditimit të Brendshëm funksionon dhe e zhvillon veprimtarinë e vet sipas një kalendarit të përcaktuar prej tij, i cili u bëhet i ditur Ministrit të Financave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Auditimit të Brendshëm.

2. Mbledhja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm thirret nga kryetari, i cili 5 ditë para mbledhjes u njofton anëtarëve rendin e ditës dhe u dërgon atyre materialet përkatëse.

3. Anëtarët e komisionit, me shumicë votash, caktojnë rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme. Në mbledhje shqyrtohen edhe probleme të ngritura nga Ministri i Financave dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Auditimit të Brendshëm.

4. Në raste të veçanta, Komiteti i Auditimit të Brendshëm mund të mbledhet edhe me urdhër të Ministrit të Financave, me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të Auditimit të Brendshëm ose të dy anëtarëve të këtij komiteti, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja e urdhrit ose kërkesës.

5. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, me shumicë votash, vendos për problemet dhe rekomandimet që do t'u paraqesë Ministrit të Financave dhe/ose Drejtorit të Përgjithshëm të Auditimit të Brendshëm. Materialet që u paraqiten Ministrit të Financave dhe/ose Drejtorit të Përgjithshëm të Auditimit të Brendshëm, kurdoherë, shoqërohen me relacionet përkatëse, ku, detyrimisht, pasqyrohen edhe mendimet kundër, nëse ka, të anëtarëve të Komitetit.

6. Kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm është jo më pak se 5 veta.

7. Kur votat e anëtarëve të pranishëm dalin në barazim, vota e kryetarit është përcaktuese. Votimi është i hapur, me përjashtim të votimit për zgjedhjen e kryetarit.

8. Kur një anëtar i Komitetit nuk merr pjesë, pa arsye, në mbledhje më shumë se 3 herë gjatë një viti, ai vlerësohet i shkarkuar dhe i takon Ministrit të Financave të emërojë një anëtar të ri.

9. Kryetari dhe anëtarët e Komitetit, për punën e kryer, marrin një shpërblim mujor në masën 20 për qind të pagës mujore të Drejtorit të Përgjithshëm të Auditimit të Brendshëm, ndërsa sekretari i Komitetit merr një shpërblim në masën 8 për qind të pagës mujore të Drejtorit të Përgjithshëm të Auditimit të Brendshëm.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga Buxheti i Shtetit, i miratuar për Ministrinë e Financave.

11. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 838, datë 26.11.2003

PËR MBROJTJEN E SHITESAVE NË NEVOJË NGA RRIJTJA E ÇMIMIT TË ENERGJISË

ELEKTRIKE DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.602, DATË 2.11.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ÇMIMET TAVAN TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PËRDORUESIT FAMILJARË DHE JOFAMILJARË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 pika 2 shkronjat "b" dhe "c", nënshkronja "i" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe të nenit 37 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e rritjes së çmimit të energjisë elektrike familjeve, që përfitojnë nga programet e mbrojtjes shoqërore, me një vlerë të përgjithshme prej 253 000 000 (dyqind e pesëdhjetë e tre milionë) lekësh.

2. Numri i këtyre familjeve të jetë deri në 191 500 (njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind).

3. Masa e kompensimit për një kilovat/orë të jetë në përputhje me vlerën e rritjes së çmimit të energjisë elektrike, të përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERRE), por jo më shumë se 0.5 lekë.

4. Skema e kompensimit dhe mënyra e pagesës përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrit të Financave, Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Ekonomisë.

5. Në tabelën që i bashkëlidhet vendimit nr.602, datë 2.11.2002 të Këshillit të Ministrave "Për çmimet tavan të shitjes së energjisë elektrike për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë", i ndryshuar, sasia prej 300 kWh e para të muajit bëhet 220 kWh.

6. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2004.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**

**VENDIM
Nr.839, datë 11.12.2003**

**PËR PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURAS
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 "Për

statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të neneve 2 dhe 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", i ndryshuar, të pikës 2 të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 8 të ligjit nr.8993, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paga bazë, sipas gradës dhe viteve të shërbimit, për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga bazë, sipas gradës, për ushtarakët aktivë, vjetërsia e të cilëve është më e ulët se ajo e përcaktuar për gradën që mban, të jetë e barabartë me pagën fillestare të gradës përkatëse. Paga bazë, sipas gradës, për ushtarakët aktivë, vjetërsia e të cilëve është më e madhe se ajo e përcaktuar për gradën që mban, të jetë e barabartë me pagën maksimale të gradës përkatëse.

3. Masa e shtesës, për kushte të veçanta pune shërbimi, për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura të jetë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura përfitojnë shtesë për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Ushtarakët aktivë, paga e të cilëve sipas pikave 1,2,3, e 4 të vendimit është më e vogël se paga dhe shtesa mbi pagën, që do të përfitojnë në çastin e zbatimit të efekteve financiare të këtij vendimi, trajtohen me shtesë "ruajtje page" për sa kohë që do të jenë në po ato funksione ushtarake, por jo më shumë se 2 vjet nga koha e zbatimit të efekteve financiare të këtij vendimi. Masa e kësaj shtese të jetë e barabartë me diferencën e pagës dhe të shtesave mbi pagë që ka përfituar ushtaraku, me pagën që përfiton ai sipas pikave 1, 2, 3 e 4 të këtij vendimi. Kjo shtesë të rillogaritet në çdo rast që bëhen ndryshime në pagat për gradë në strukturat e Forcave të Armatosura.

6. Vendimet nr.60, datë 27.2.1992 "Për trajtimin me pagë dhe shtesë mbi pagë të ushtarakëve në ushtri", nr.88, datë 30.1.1998 "Për pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", nr.344, datë 21.7.1999 "Për trajtimin me shtesë mbi pagën bazë për natyrë të veçantë pune e shërbimi të ushtarakëve që shërbejnë në strukturën e Batalionit Special të Brigadave Komando", nr.115, datë 18.3.1999, pika 4, 5, 6 e 7, "Për një ndryshim në strukturën organike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për trajtimin financiar të personelit, që do të aktivizohet për pastrimin e asgjësimit e municioneve e eksplozivave", nr.125, datë 27.2.2003 "Për trajtimin me shtesë për vështirësi vendi e shërbimi të ushtarakëve, që shërbejnë në strukturat e brigadës së reagimit të shpejtë dhe të brigadës së stërvitjes", nr.405, datë 3.4.1995 "Për trajtimin me shtesë mbi pagën bazë për vështirësi vendi e shërbimi të ushtarakëve, që punojnë në strukturat e radiozbulimit të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes" dhe nr.244, datë 20.4.2002, pika 2, "Për masën e pagesës për përjashtimin nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv, si dhe për trajtimin e ushtarëve me pagesë" të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2004.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Vitet e sherbimit

	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Gjeneral															145000
Gj. Lejt (Admiral)															140000
Gj. Major (Nenadmiral)															133800
Gj. Brigade (Kunderadmiral)														131200	103700
Kolonel (Kapiten i rangut I-re)													101700	76400	103700
Nenkolonel (Kapiten i rangut II-te)											74900	76400	78000	79600	81200
Major (Kapiten i rangut III-te)									55700	56800	57900	59000	60200	61400	62600
Kapiten (Kapiten lejtant)							37900	38600	39400	40200	41000	41800	42600		
Toger (Lejtant)				34000	34700	35400	36100	36800	37500	37500	37500				
Nentoger (Nenlejtant)	29600	30200	30800	30800	30800	30800	30800								

Vitet e sherbimit

[illegible]

[illegible][illegible]

Masa e shteses per natyre te vecante qe perfitojne ushtaraket ne Forcat e Armatosura

Nr.	Personeli ushtarak qe perfiton shtese per natyre te vecante	Masa e shteses (ne leke)
1	Mjeket qe sherbejne ne Forcat e Armatosura	8000
	Pilotet e emeruar ne pozicione organike qe kerkojne kryerjen e fluturimeve. Parashutistet.	
	Oficeret apo nenoficeret ne detyre dhe ne kualifikim si zhytesa.	
	Oficeret nenoficeret apo ushtaret profesioniste te kualifikuar, qe sherbejne ne njesite Asgjesimit me Eksploziv te Municioneve dhe qe kryejne operacione per shkaterrimin e municioneve dhe eksploziveve.	
	Oficeret nenoficeret apo ushtaret profesioniste te emeruar ne Batalionin Special, te cilet kryejne detyra taktike te batalionit Special.	
	Oficeret nenoficeret apo ushtaret profesioniste te emeruar ne regjimentin Komando, qe kryejne detyra taktike komando.	
	Personeli ushtarak radiozbulues i Qendres se Radiozbulimit qe sherben ne repartet Kroi Bardhe-Kukes,Tarabosh - Shkoder,Çardhak-Korce dhe Mali i Krujes	
2	Personeli (ushtarak) administrativ dhe ai ndihmes te cilet jane emeruar ne Batalionin Special, por nuk kryejne detyra taktike te batalionit Special.	5000
	Personeli ushtarak administrativ dhe ai ndihmes te cilet jane emeruar ne Regjimentin Komando, por nuk kryejne detyra taktike Komando.	
	Oficeret nenoficeret apo ushtaret profesioniste ne Brigaden e Stervitjes qe jane emeruar ne funksione dhe kryejne direkt stervitjen baze.	
	Personeli tjeter ushtarak i Qendres se Radiozbulimit qe sherben ne repartet Kroi Bardhe-Kukes,Tarabosh - Shkoder,Çardhak-Korce dhe Mali i Krujes.	
	Personeli nenoficer dhe ushtar profesioniste operatore radiozbulues ne strukturat e Qendres se Radiozbulimit	
3	Pilotet e emeruar ne pozicione organike qe nuk kerkojne kryerjen e fluturimeve. Personeli mirembajtes inxhinjero teknik i aviacionit. Personeli fluturues teknik e mekanik.	3000
	Oficeret me specialitete detare te emeruar ne pozicione organike qe kerkojne kryerjen e lundrimeve dhe personeli ushtarak (oficer, nenoficer dhe ushtar profesioniste) i emeruar ne anije.	
	Personeli ushtarak radiozbulues i Qendres se Radiozbulimit qe sherben ne strukturat Shtoj, Kruje, Korce, Kavaje, Sarande te Qendres se Radiozbulimit.	

**FUNKSIONET USHTARAKE QE PERFITOJNE SHITESE PER PUNE TE VESHTIRE E TE DEMSHME NE
SHENDET NE STRUKTURAT E FORCAVE TE ARMATOSURA**

Nr	Emertimi i funksionit	Shtesa mujore ne leke
1	Ne Laboratorin e Municioneve: Shef i sektorit dhe repartit e teknik laborant te analizave fiziko-kimike. Shef i repartit e teknik laborant te analizave kimike. Teknik laborant e shofer i autolaboratorit	7400
2	Ne sherbimin e anatomise e patologjise SUQU: Mjek. Laborant histolog Ne sektorin e analizave instrumentale e Sektori i MKK ne Laboratorin Qendror te Forcave te Armatosura: Shefi i sektorit. Teknik i mesem kimist Ne sektorin e prodhimit te gypave indikator te LHL ne Laboratorin Qendror te Forcave te Armatosura: Shefi i sektorit. Inxhinjeri i prodhimit te kimikateve. Magazinjer	6600
3	Ne sherbimin e kirurgjise, traumatologjise, neurokirurgjise, sallat e operacionit, ne reanimacionin kirurgjikal, ORL, okulistike SUQU: Mjek neurorkirurg Ne laboratorin kimik biokimik SUQU: Mjek laborator. Laborant. Inxhinjer kimist ne laborator Ne sherbimin higjeno epidemiologjise SUQU: Teknik i mesem laborant kimist. Inxhinjer kimist Ne sherbimin e ortopedise e traumatologjise SUQU: Mjek kirurg qe punon me rreze X (manipulon) Ne sektorin e prodhimit te gypave indikator te LHL ne Laboratorin Qendror te Forcave te Armatosura: Teknik i mesem preparatori	5200
4	Ne sherbimin e kirurgjise, traumatologjise, neurokirurgjise, sallat e operacionit, ne reanimacionin kirurgjikal, ORL, okulistike SUQU: Infermier ne sallat e operacionit. Anestezilog dhe personeli ne sallat e reanimacionit te kirurgjise Ne sherbimin e anatomise e patologjise SUQU: Prozektor Ne sherbimin pneumoftiziatrise SUQU: Mjeku pneumolog Ne Laboratorin Qendror te FA: Shefi i laboratorit Ne sektorin e analizave fushore ne Laboratorin Qendror te Forcave te Armatosura: Shefi i sektorit. Teknik i mesem kimist Ne sektorin e kolaudimit te aparatures dozimetrike e kimike ne Laboratorin Qendror te Forcave te Armatosura: Shefi i sektorit. Instruktor per dozimetrin. Teknik i mesem dozimetrist Ne sektorin e prodhimit te gypave indikator te LHL ne Laboratorin Qendror te Forcave te Armatosura: Teknik i ampulave. Teknik i mesem ventilimi Ne Regjimentin e Nderlidhjes: Teknik rendues ne qender, teknik rendues ne VK1, teknik i aparateve dhe i rrjetit telefonik ne MM, teknik i centralit automatik ne MM, shefi i centralit, shef i telegrafes, centralist dhe telegrafist ne qendren e nderlidhjes dhe VK1. Shef i SUE, akumulatorist, baterist Ne Vendkomanden Qendrore: Shef (radist) i radiatorrit te raportimit te QKRA, te grafikut nr.1, 2, 3, shef (radist) i radiatorrit te QKRA ne VK te aviacionit te grafikut 1 e 2, shef (radist) i rrjetit te komandimit me mjete te ushtrise te grafikut nr.1,2 e 3.	4400
5	Ne gjithë njesite e repartet ushtarake: Mjek radiolog. Fillrojtës Ne sherbimin e radiologjise SUQU: Mjek radiolog. Laborant rontgeni Ne sherbimin e kardiologjise, reanimacionit terapeutik SUQU: Mjek hematolog Ne sherbimin e mirembajtjes dhe riparimeve SUQU: Oksigjenist. Riparues i aparaturave elektromjekesore Ne oficen e ortopedise SUQU: Protezist Ne SUQU: Mjeku traumatolog dhe personeli i salles se operacionit kur operojne me aparat rontgeni (Masa e shiteses te jete ne raport me ditet e punuara ne fakt) Ne laborator ne brigaden e furnizimit: Shef laborator Ne depo kimie Qaf Molle, Brar ne brigaden e furnizimit: Magazinjer. Ne objektet nentokesore te ruajtjes se municionit ne brigade furnizimi: Magazinjer. Ne Regjimentin e Nderlidhjes: Shef i sektorit te kablllove, kabllist, telefonist, telefonist e fillrojtës	3700

Nr	Emertimi i funksionit	Shtesa mujore ne leke
6	Ne gjithë njesite e repartet ushtarake: Magazinjer karboranti. Dozimetrizist ne oficine. Ne batalionin e kimise se Forcave Tokesore: Shef teknikes speciale dhe aparatures. Magazinjer armatimi rezerve e kimikateve. Ne batalionin e nderlidhjes se Forcave Ajrore: Shtabi i batalionit, komandant toge, komandant kompanie, nenoficer kompanie Ne kabinetin e fizioterapise SUQU: Mjeku. Infermier laborant Ne sektorin e kolaudit te aparatures dozimetrike e kimike ne Laboratorin Qendror te Forcave te Armatosura: Shofer i transportit te lendeve radioaktive Ne Brigaden e Xhenjos: Minator kur punon nen toke Ne Regjimentin e Nderlidhjes: Komandanti i qendres, komandanti i nenrepartit te telefonise, shefi i teknikes se qendres se nderlidhjes, teknik i frekuences se larte Ne Vendkomanden Qendrore: Shef i VKQ, pergjegjes grupi drejtimi, oficer sherbimi komunikimi, oficer drejtimi e AKA, oficer drejtimi RT, shef i VKRT, shefi i trafikut ajror, shef i grupit RM, shef (radist) i komandimit te qendrave kontroll raportimit ajror, shef (radist) i radiatorit te komandimit te aviacionit, shef (radist) i radiodhenesave te QKRA, shef (radist) i radiodhenesave te komandimit me mjete te ushtrise, shef (radist) i Radio speciale (operator) i mjeteve toke ajer, shef i perpunimit te situates ajrore nga QKRA, shefi i perpunimit situates ajrore nga njesite e ushtrise, shef centrali (centralist) i aparatures se dendesimit, shef centrali MFA, shef i radioreleve (relist), teknik i mirembatjes. Oficer drejtimi aviacioni.	3000
7	Ne gjithë njesite e repartet ushtarake: Mjek kirurg. Laborant klinik biokimik. Shofer autoboti karboranti. Baterist akumulatorist. Operator i terminaleve. Baterist e Saldator me oksigjen ne oficine. Ne Forcat Tokesore dhe repartet vartese te saj: Shef i stacionit te zbulimit radioteknik. Kryeoperator i stacionit te zbulimit radioteknik. Shef i radiolokacionit. Komandant toge radioteknike. Instruktor dhe teknik per SDT. Kryeoperator i SDT. Shef i P-10. Kryeoperator i P-10. Shef i SRRLL dhe ADQ. Shef i llokacionit ne bateri. Magazinjer kimie qe administron LHL. Pedagog informatike qe punon mbi 4 ore ne kompjuter. Ne batalionin e kimise te Forcave Tokesore: Komandant skuadre e shofer karooficine teknik i MKK e autolaborator. Teknik riparimi Ne Brigaden e Raketave: Komandant grupi RDKA. Teknolog ne laboratorin e karburanteve speciale. Teknolog i linjes se karburanteve speciale. Teknik per instrumentat mates kontrollues te SDR. Teknik per frekuencen e lartesishte SDR. Shefi i stacionit te kabines elektrike. Shef i teknikes speciale te grupit RDKA. Shef i stacionit kabines komandave. Shef i stac. kabine. RDHK. Shef i stac. kabine. kordinative. Shef i stac. kabine. indikator. Shef i stac. kabine. dhenese marres. Shef i repartit te SDR ne oficine. Shef i repartit kontroll raketes. Shef i oficines se RDKA. Shef i karburanteve speciale. Ne Brigaden e Raketave: Riparues i linjes se karburanteve speciale dhe shofer i transportit te karburanteve speciale. Operator repartit kontrollit raketave. Kryeteknike per aparaturen e autopilotit. Kryeteknik per furnizimin me karburante speciale. Kryeoperator repartit kontrollit raketave. Kryeoperator i kabine indikator. Kryeoperator i kabine dhenese marrese. Komandant i baterise radioteknike. Inxhinjer per raketat. Instruktor per sistemin e komandimit. Instruktor per sistemin dhenese marres. Instruktor per radiodhenesin e komandave. Instruktor per kabinen dhenese marrese. Instruktor per kabinen indikatore Ne batalionin e veshgimit ajror: Teknik per radiolokacionin. Shefi i postes radioteknike. Shefi i kabines indikatore. Shefi i kabines dhenese marrese. Shef teknike grupi radioteknik. Shef shtabi grupi radioteknik. Shef sherbimi radioteknik. Shef radioteknik i diapazonit metrik, decimetrik, centimetrik. Shef i stacioni radiolokatori. Radio mekanik per riparimin e teknikes radiolokatore. Kryeoperator stacioni radiolokator. Komandanti i postes radioteknike. Komandant grupi radioteknik Ne Komanden e MKA: Shefi deges zbulim radiolokacionit (kryeinxhinjeri). Instruktor per zbulimin e larget. Instruktor per SD. Ne Grupimin K/A Tirane: Shef zbulimi radiolokacioni. Instruktor per SDT. Ne Grupimin poligonal i MKA: Shefi i postes vrojtimit radiolokative. Kryeoperator. Ne Oficinen e komandes MKA: Shefi i repartit te zbulimit te larget. Shefi i repartit te SDT. Teknik per SDT. Shefi i oficines Ne repartet e aviacionit: Komandant grupi R/Drites. Shef i grupit SUQ. Kryeoperator SUQ. Shef i lokatorit P-10. Kryeoperator i P-10. Teknik i tensionit te larte. Teknolog per oksigjenin. Kompresorist. Elektro mekanik i bazes se karikim akumulator te nderlidhjes. Mekanik avioni (axhustator qe punon ne tunel). Mekanik i pajimeve speciale qe punon ne tunel. Mekanik radio avionit qe punon ne tunel. Mekanik armatim avionit (elektro mekanik, axhustator) qe punon ne tunel. Tornitor qe punon ne tunel. Axhustator qe punon ne tunel Ne repartet e transportit: Oksigjenist. Shoferet e municionit dhe shoqeruesit e tyre (vetem gjate kohes qe transportojne municion)	2200

Nr	Emertimi i funksionit	Shtesa mujore ne leke
8	Ne gjithë njesite e repartet ushtarake: Shaptilografist. Kabllist. Veteriner. Mjek stomatolog. Shefi i higjenes e epidemiologjise. Mjek patholog. Farmacist. Kryeinfermier. Infermier. Ndhimes farmacist. Bojaxhi e Oksidues ne oficine. Ne Laborator te kimise se Forcave Tokesore: Laborant. Ne oficine te Forcave Tokesore: Fonditor. Tornitor. Motorrist. Xhenerik. Axhustator. Riparues MKK. Ne batalionin e kimise te Forcave Tokesore: Laborant. Magazinjer per kimine, rezerven e stervitjen. Motorrist, xhenerik. Elektroaut Ne Brigaden e Raketave: Xhenerik. Tornitor. Teknik per riparimin e SH.L. Teknik per riparimin e mjeteve te furnizimit me karburante speciale. Shefi i furnizimit me ajer. Shef i repartit te mjeteve te furnizimit me karburante speciale. Shef i repartit te furnizimit te raketave. Shef i agregatit SET - 75. Motorrist. Kryemekanik per furnizimin me oksidues. Komandanti i baterise se ruajtjes dhe pergatitjes se raketave Ne repartet e aviacionit: Laborant karboranti. Shef i elektro gazit. Motorrist. Xhenerik. Specialist i instrumentave mates kontrollues. Ne Arkivin Qendror te Forcave te Armatosura: Restaurator Ne Qendren e Radiozbulimit: Teknik me specialitete te ndryshme Ne sherbimin e kirurgjise, traumatologjise, neurokirurgjise, sallat e operacionit, ne reanimacionin kirurgjikal, ORL, okulistike SUQU: Infermier mjekimi. Infermier pavioni Ne sherbimin e urgjences kirurgjikale SUQU: Pergjegjes materialesh. Barrelembartes Ne sherbimin e pranimit SUQU: Mjek. Infermier. Pergjegjes materialesh Ne sherbimin e kardiologjise, reanimacionit terapeutik SUQU: Kardiolog. Infermier te pavionit. Pergjegjes materialesh Ne sherbimin gastroenterologjise SUQU: Mjeku gastroentolog. Infermiere manipulimi. Infermiere pavioni. Infermiere fibrogastroskopik. Pergjegjes materialesh Ne sherbimin pneumoftiziatrise SUQU: Infermier manipulimi. Infermier pavioni. Pergjegjes materialesh Ne sherbimin e infektivit SUQU: Mjeku infeksionist. Infermier manipulimi. Infermier disinfektues. Infermier pavioni. Pergjegjes materialesh Ne shperbimin e stomatologjise SUQU: Mjek stomatolog per terapine. Laborant. Nd.stomatolog per terepine Ne sherbimin e toksikologjise, radiobiologjise SUQU: Infermier pavioni. Pergjegjes materialesh. Mjek dermatolog Ne sherbimin higjeno epidemiologjise SUQU: Mjek higjenist. Mjek epidemiolog Ne sherbimin e mirembajtjes dhe riparimeve SUQU: Teknik me specialitete te ndryshme. Ne sherbimin e transportit SUQU: Xhenerik. Mekanik. Shofer i transportit komunal Ne sherbimin e ortopedise e traumatologjise SUQU: Pergjegjes materialesh Ne administrate SUQU: Kryeinfermier i pergjithshem. Ne brigaden e Furnizimit: Motorist. Xhenerik. Ne laborator ne brigaden e furnizimit: Laborant ushqimi Ne farmaci ne brigaden e furnizimit: Farmacist. Ne magazinene e rezervave te shendetesise ne brigaden e furnizimit: Magazinjer. Ne depo kimie Qaf Molle, Brar ne brigaden e furnizimit: Furnitor Kolaudator	1500

Nr	Emertimi i funksionit	Shtesa mujore ne leke
8	Ne repartet e Forcave Detare: Axhustator. Motorist. Tornitor - Ribatinist. Frezator. Xhenerik. Tornitor. Tubomekanik. Manovrator (ne tunel) Ne shkollat ushtarake: Ndhimes farmacist. Ndhimes stomatolog. Laborant ne infermieri. Tornitor. Ne Institutin Gjeografik Ushtarak dhe ne Insitutin e Studim Projektmeve te Mbrojtjes: Heligrafist ne ISPMb. Ne laboratorin e pergatitjes solucioneve kimike ne Institute: Laborant Ne laboratorin e fotoradhitjes e Laboratori multipleks ne Institute: Topogjeodet. Teknik me specialitete te ndryshme Ne aparatin e Ministrise se Mbrojtjes: Shefi i departamentit te higjenes dhe epidemiologjise. Shefi i sherbimit farmaceutik. Mjeku qe merret me fibroskopi per aq kohe sa perdor fibroskopi Ne Brigaden e Xhenjos: Kryesondist. Sondist. Ndhimes sondist. Tornitor Ne Regjimentin e Nderlidhjes: Motorrist. Xhenerik. Tornitor. Telegrafist. Radiotelegrafist ne rrjetet e komunikimit te vazhdueshem. Radiofonist ne rrjetet e komunikimit te vazhdueshem. Teknik i centralit automatik, elektromekanik ne qendren e nderlidhjes ne MM Ne Qendren Kulturore te Forcave te Armatosura: Magazinjer pergjegjes salle operator. Fonist. Fotoreporter montazhier arkivist filmi. Instrumentistet Ne Vendkomanden Qendrore: Shef (motorist) i grupeve elektrike	1500
9	Ne gjithe njesite e repartet ushtarake: Kaldaist. Punonjesit qe punojne mbi 4 ore ne tunel. Saldator me elektrik ne oficine. Ne oficine te Forcave Tokesore: Radiotorist. Farketar. Gomist. Bakelist. Lavazhier grasatorist. Ne repartet e aviacionit: Motorrist elektrikist ne mirembajtjen e tuneleve. Personeli inxhinjer teknik i avionit radios, pajimeve speciale, i armatimit qe punon ne tunel. Teknolog i sektorit mekanik qe punon ne tunel Ne repartet e transportit: Lavazhier. Radiotorist. Gomist Ne administrate SUQU: Infermier i statistikes Ne repartet e Forcave Detare: Riparues i teknikes se silurave Ne Institutin Gjeografik Ushtarak dhe ne Insitutin e Studim Projektmeve te Mbrojtjes: Skavist, analist. Ne grupin e drejtimit te Ministrise se Mbrojtjes: Pergjegjes grupi, ndihmes pergjegjes grupi, oficer sherbimi ne grup drejtimi, pergjegjes i grupit drejtim per zbulimin ne MM	800

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 23.12.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë